



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA E KURRIKULËS DHE KUALIFIKIMIT

Nr.prot. _____

Tiranë, më ____ . ____ .2024

**NJOFTIM PËR BASHKËPUNËTORË TË JASHTËM PËR HARTIMIN E FONDIT TË
PYETJEVE TË TESTIMIT NË KUADËR TË PROCEDURAVE TË REKRUTIMIT TË
PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL**

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), kërkon bashkëpunëtorë të jashtëm, hartues të fondit të pyetjeve, në kuadër të procedurave të rekrutimit të punonjësve të shërbimit psiko-social.

Bashkëpunëtorët e jashtëm për hartimin e fondit të pyetjeve në kuadër të procedurave të rekrutimit të punonjësve të shërbimit psiko-social duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

1. Të kenë mbaruar arsimin e lartë në ciklin/profilin përkatës.
2. Të kenë përvojë mbi 5 vjet si punonjës i shërbimit psiko-social.
3. Të zotërojnë leje për ushtrimin e profesionit,
4. Të kenë marrë pjesë në veprimtari të ndryshme trajnuese për zhvillimin e tyre profesional.
5. Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
6. Të përdorë kompjuterin.

Kandidatët për hartues të fondit të pyetjeve dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm pranë sekretarisë së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), brenda datës 05.12.2024, ora 16:00:

- CV
- Diplomë e studimeve
- Licencë - leje ushtrimi profesionit
- Kartë identiteti
- Certifikata të ndryshme

Faleminderit!